

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese, ndaj korrupsionit.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuese, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Njëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë njëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Shkurt, 2022

Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit zhvillon takimin me partnerët dhe donatorët në fushën antikorrupsion, për vitin 2022

22.02.2022. Ministri i Drejtësisë në ushtrim të rolit të tij të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit zhvilloi takimin e posaçëm vjetor me të gjithë partnerët dhe donatorët e fushës antikorrupsion. Përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, të ambasadës së SHBA-së, të të gjithë ambasadave në Tiranë, organizata ndërkombëtare dhe vendase, iu përgjigjën ftesës së z. Manja, për të qenë pjesë e takimit dhe shprehën angazhimin për të vijuar mbështetjet teknike e logjistike në luftën kundër korrupsionit. Në takim u paraqit një listë me kërkesa për mbështetje konkrete, fokusuar në të tre qasjet e politikës antikorrupsion (parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim). Mbështetje për strukturën e riroganzuar antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion, dhe institucionet e tjera me fokus ndëshkimin e korrupsionit morën vëmendje të veçantë në takim.

Takimi i zhvilluar u publikua edhe në rrjetet sociale të Ministrisë së Drejtësisë, në këtë link: <https://www.facebook.com/manjaulsi/posts/344322517704153>



Raporti vjetor i monitorimit, 2021, të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, në proces konsultimi

28.02.2022. Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka përfunduar draftin e parë të hartimit të raportit të monitorimit për vitin 2021, të Planit të Veprimit Antikorrupsion, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Ky raport monitorimi merr në analizë të thelluar dhe krahasimore ecurinë e 18 objektivëve të Strategjisë, duke bërë një vlerësim të 37 indikatorëve të saj përkundrejt vlerave të synuara për vitin 2021, të 64 masave dhe 119 aktiviteteve. Drafti i parë është dërguar për konsultimin paraprak pranë të 22 institucioneve zbatuese si dhe Kryeministrit për mënyrën e analizës së kryer, gjithashtu. Ky raport monitorimi reflekton progresin e vitit të 7-të të Strategjisë, dhe i 2-të të Planit të Veprimit në fuqi. Ky raport do të përmbajë një vlerësim të dedikuar të impaktit që ky dokument ka sjellë në arritjen e objektivave me qëllim integrimin evropian të vendit. Drafti pas vlerësimit të parë, do të ridërgohet për konsultim me institucionet dhe me të gjithë të interesuarit, në faqen e Ministrisë së Drejtësisë, në javën e parë të muajit mars 2022.



Projekti “Kurrikula antikorrupsion në shkollat e mesme” vijon zbatimin


1 - 4.02.2022. Ministria e Drejtësisë ka vijuar me zbatimin e projektit “Kurrikula antikorrupsion në shkollat e mesme”, në 4 gjimnaze të Tiranës. Nxënësit e shkollave “Asim Vokshi”, “Petro Nini Luarasi”, “Qemal Stafa” dhe “Asim Vokshi”, të shoqëruar nga mësuesit e tyre të lëndës së Qytetarisë, u bënë partnerë të projektit antikorrupsion. Ekspertë të fushës antikorrupsion të Ministrisë së Drejtësisë, së bashku me mbështetjen e partnerëve të ambasadës italiane në Tiranë zhvilluan 4 takime me nxënës të shkollave. Kuptimi i korrupsionit, mekanizmat e luftës antikorrupsion, instrumentat që qytetarët mund të përdorin për të denoncuar korrupsionin, aktivizimi i të rinjve kundër korrupsionit ishin çështje që u diskutuan me nxënësit. Bisedat dhe shkëmbimi i njohurive të fushës rritën interesin e nxënësve për të njohur dhe përdorur këto mekanizma në përditshmërinë e tyre. Këto takime ishin përmblylla e pjesës së parë të projektit, i cili do të vijojë gjatë muajit mars me aktivitete krijuese në partneritet me organizatën italianë “Avviso Publico”. Nxënësit do të krijojnë një projekt antikorrupsion mbështetur në njohuritë e marra.



Udhëzuesi “Antikorrupsioni”, një instrument ndërgjegjësimi i luftës kundër korrupsionit

15.02.2022. Ministria e Drejtësisë rrit ndërveprimin në luftën kundër korrupsionit. Botimi “Antikorrupsioni” është një instrument ndërgjegjësimi dhe informimi i luftës kundër korrupsionit i përgatitur në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për çdo qytetar shqiptar por edhe të huaj që jeton dhe punon në Shqipëri. Udhëzuesi jep informacion për krimin e korrupsionit, kuptimin terminologjik (gjuhësor dhe juridik) të tij, format dhe mënyrat e shfaqjes së tij, masën e ndëshkimit të korrupsionit sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, organet ku mund të denocohet korrupsioni me adresat dhe mënyrat e kontaktit. Udhëzuesi “Antikorrupsioni” mund të gjendet në çdo institucion ku është shtrirë Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion, në institucione ku ofrohen shërbime direkte për qytetarët. Ky botim është mundësuar me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë.


Botimi gjendet i publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në këtë link: <https://drejtesia.gov.al/viti-2022/>



Ndërkombëtarizimi dhe forcimi i bashkëpunimit antikorrupsion

8.02.2022. Rrjeti i Agjencive Parandaluese Antikorrupsion (NCPA) zhvilloi takimin e parë për vitin 2022. Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, njëkohësisht edhe anëtare e Grupit Drejtues të NCPA, diskutoi planin e punës dhe të aktiviteteve për vitin 2022. Sekretariati Teknik i NCPA këtë vit drejtohet nga Autoriteti i Transparencës Kombëtare të Greqisë, i cili prezantoi projektin e punës, i fokusuar në 4 shtylla: organizimin e 4 webinarëve/konferencave; përgatitjen e 3 udhëzuesve; planifikimin dhe organizimin vizitave studimore me qëllim shkëmbimin e eksperiencave mes vendeve anëtare si dhe përgatitjen e raportimeve të Rrjetit. Përfaqësuesit e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit ofruan gadishmërinë e pjesëmarrjes në disa prej konferencave dhe të vizitave për t'u organizuar si dhe do të bashkëdrejtojnë me përfaqësuesit e Italisë, udhëzuesit për hartimin dhe monitorimin e strategjive antikorrupsion.

Informacion të mëtejshëm mbi takimin e NCPA mund të gjeni në këtë link: <https://www.coe.int/en/web/corruption/ncpa-network>



Kapacitete të shtuara njerëzore dhe rritje profesionale për Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion

28.02.2022. Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë ka shtuar kapacitetet në burime njerëzore në të tre drejtoritë e saj: Drejtorja e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, Drejtorja Operacionale për Çështjet Antikorrupsion dhe Drejtorja e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion. Departamenti i Administratës Publike së bashku me drejtues të njësisë përgjegjëse antikorrupsion ka marrë në shqyrtim aplikime të shumta të të interesuarëve për të qenë pjesë e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion. Nga ana tjetër, rritja e kapaciteteve profesionale të stafit antikorrupsion është gjithashtu një prioritet i drejtorisë. Trajnime për hetimin administrativ të korrupsionit, përgatitja dhe kualifikimi i stafit për hartimin dhe raportimin qeveritar për rekomandimet në GRECO (mënyra e raportimit) si dhe propozimet për ngritjen e Zyrës së Rekuperimit të Aseteve, janë tematikat për trajnim për tu zhvilluar së shpejti me asistencën direkte të zyrës të Këshillit të Evropës në Tiranë.

